
NËPËR HULLITË E KONSTRUKTIONIT

Prof. Asoc. Albana Deda

Universiteti i Tiranës

albana.deda@fhf.edu.al

Abstract

The lack of application of the semantic criterion in grammatical characterization is evident in Albanian Grammar I and II. Such a statement is easily recognizable, if we consider many word classes and their grammatical categories. We can mention the category of case and its completely formal treatment, which leads to a purely formal description, focused in identifying of desinences in morphological level and traditional functions in syntactic one. In this context, the concept of semantic case and the diversity of its expression structures in the structure of Albanian, would be a good alternative to treatment within the framework of the syntagm.

Likewise, degree is a category treated completely elliptically in Grammar I. The lack of application of semantic degree leaves out an entire semantic and structural wealth of the Albanian corpus.

The mostly aspectual characterization of verb tenses, as well as their incomplete semantic description, is another issue that requires a solution in Grammar I.

Also, the precise definition of the category of aspect, which is not peripheral, but has distinct manifestations especially at the semantic level, we think should be reconceptualized in our referential treatments.

However, the main focus of this paper will be the presentation of the main elements of the Theory of Constructs. Adele Goldberg and her contribution on this field has been the main referential theoretical corpus of this paper. Since in Albanian studies this theory is not well known, and has lacks for applications, we judge that this information that specialised readers would find here would be useful for them.

Key words: construction, form, meaning, schematic elements, substantive elements.

Hyrje

Në përgjithësi, në studimet tona hulumtimi në rrafsh semantik është përqendruar më së shumti në kuadrin e fjalës dhe kuptimeve leksikore¹ të saj (edhe këtu natyrisht që në pak studime gjen referencat e fjalës sipas niveleve studimore, pra fjalës fonetike, gramatikore, semantike, Plag 2002, 49; Bas Aart 2011, 1.2-1.3 etj.).

Duke iu referuar traditës pararendëse pra 90-tës një pohim i tillë është lehtësisht i dallueshëm (Kemi parasysh kontributin kryesor të prof. Jani Thomait. Edhe sot lënda që u referohet këtyre njohurive në fakultet quhet leksikologji²).

Edhe pas 90-tës, pavarësisht se në botë studimet semantike kanë pësuar një zhvillim të jashtëzakonshëm, duke rikonceptuar metodologjitë dhe veçanërisht duke zgjeruar korpusin e hulumtimit, pra jo vetëm në kufijtë e fjalës, po edhe të morfemës, edhe të konstruktit etj. sërish konstatojmë se këtu në pak raste janë reflektuar këto remineshenca, si në kuadrin e ngushtë, ashtu dhe në atë ndërnivelor.

Në lidhje me semantikën, në rrafsh gramatikor ka autorë që kanë dhënë kontribute në këtë aspekt më së shumti në kuadrin e vëzhgimit semantik- gramatikor gjenerativ e deskriptiv (Memushaj 2003, 2008; Kallulli 2006; Kananaj 2009; Koleci & Turano 2011; Deda 2017, 2019, 2023 etj.).

Gjithsesi, studime kodifikuese edhe në këtë drejtim nuk ka pasur. Dëshmi është Gramatika I dhe II (ribotim 2002), që vazhdon të jetë teksti referues në të gjitha nivelet.

¹ KUPTIM m.

1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve KUPTOJ, KUPTOHEM. Kuptim i drejtë (i shtrembër, i gabuar). Kuptimi i gabimit. Kuptimi materialist i historisë. Fjalori i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave, 1980.

2. Përmbajtja a domethënia e diçkaje, ajo çfarë shpreh a çfarë do të thotë diçka. Kuptimi politik (ideologjik). Fjalë (punë, veprime) pa kuptim. Ç'kuptim ka kjo? S'ka kuptim është e kotë. Në kuptimin e ngushtë (e gjerë, e plotë) të fjalës. Në kuptimin e vërtetë të fjalës. Me plot (me tërë) kuptimin e fjalës.

gjuh. Përmbajtja e fjalës, e cila shpreh diçka nga realiteti; përmbajtja e një njësie gjuhësore, tërësia e funksioneve të njësive gjuhësore. Kuptimi leksikor. Kuptim i drejtpërdrejtë (i figurshëm, abstrakt, konkret).

3. Kuptimi kryesor (fillestar). Kuptim i ri. Kuptim i vjetruar. Kuptimi gramatikor. Kuptimi kohor (i kohës).

Kuptimi sasiar (cilësor). Kuptimi i rrënjës (i parashtesës, i prapashtesës). Kuptimi i morfemës. Kuptimi i fjalisë.

4. Fjalë me shumë kuptime. Zhvillimi (ndryshimi, zgjerimi, ngushtimi, ndërrimi) i kuptimit. bised. Aftësia për t'i kuptuar gjërat; aftësia për t'i kuptuar gjërat shpejt, zgjuars. Njeri pa kuptim. Aq kuptim ka ai.

* Kuptimi i drejtpërdrejtë (i fjalës) gjuh. shih te DREJTPËRDREJTË (i, e). (Fjalori i gjuhës së sotme shqipe).

² J.Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, SHBLU, 2006.

Siç vumë re dhe më lart, në përgjithësi kriteri semantik edhe kur është përmendur në këtë Gramatikë më së shumti është diskutuar në kufijtë e një kategorie leksikore, pra në kufijtë e fjalës. Madje në Gramatikën I në mënyrë konsistente për secilën pjesë ligjërate fillimisht jepen ndarjet/ klasifikimet në bazë të kriterit semantik. Është e dallueshme se trajtimi në bazë të kriterit semantik në këtë Gramatikë është mjaft sipërfaqësor dhe mungesor, nuk ka një bazë të qartë teorike dhe nuk përgjithëson gjithë korpusin e shqipes.

Në këtë kontekst veç vërejtjeve në auditor ka vite që ne kemi dhënë edhe sugjerimet tona në lidhje trajtimin e këtij kriteri në kategori leksikore të ndryshme³.

Janë edhe tri artikuj në proces botimi ku ka analiza, në të cilat analizohen koncepti i metaforës dhe i metonimisë konceptuale, ku debati për përbërësen semantike është i pashmangshëm.

Metodologjia e punës

Punimi ynë, në përgjithësi, i përket rrafshit teorik dhe bazohet në prezantimin metodologjik të Teorisë Konstruktiviste CxG, përkatësisht linjës së ndjekur nga Adele Goldberg-u (1995), por jo vetëm. Konstruktivizmi është një teori që tashmë nuk mund të quhet e re, pasi sot janë qindra punime në rrafsh teorik e aplikativ në lidhje me të, madje kanë filluar edhe kritikata që u referohen parimeve bazë të saj. Në këtë kontekst, menduam që të sjellim disa tipare të linjës konstruktiviste, pa pretenduar që të kemi kryer një aplikim të plotë në korpusin e shqipes. Për këtë arsye, punimi ka karakter përshkrues dhe krahasues-interpretues.

Zanafilla e konstruktivizmit

Zanafillën e kësaj teorie disa autorë e shohin që në lashtësi (Harris and Taylor,

³ Me këtë po u referohemi punimeve tona si :

Albana Deda & Daniela Hasa, “Issues of Gradability in Albanian Language Traditional Studies”, 2011 , Albana Deda & Leonora Lumezi, The Traditional Conception of Diathesis (Voice) and a Modern View to It, 2015 .

Albana Deda, Diateza: kategori morfologjike apo valencë (monografi), 2017,

Albana Deda, The necessity to study the semantic valence in the structure of albanian language, 2019 . Albana Deda & Idriz Metani, Means in the context of the compound predicate or complete verbs (data by Gege and Toske dialects), 2020 ,

Albana Deda& Monica Genesi& Monica Hasani, The Conceptual Metaphor and the Need to Identify It in the Albanian Literary Corpus, 2023 .

Albana Deda & Monika Hasani, Word Formation Head and the Typology Analysis of the Word Formation Corpus in Albanian, 2023 .

1997), po ishte ardhja e gjenerativizmit që e mënjanoi si praktikë. Michealis (2006) u referohet punimeve të këtyre autorëve si zanafilla e CxG: Fillmore et al.(1988); Kay and Fillmore (1999); Kay (2002); Zwicky and Pullum (1991); Zwicky (1994, 1995); Goldberg (1995, 2002); Michaelis and Lambrecht (1996); Michaelis and Ruppenhofer (2001); Goldberg and Jackendoff (2004) etj.

Sipas saj, ka disa teori që përcaktojnë *se semantika dhe struktura sintaksore e një fjale (struktura argumentore e saj) mund të përdoret për të parashikuar semantikën dhe strukturën e krejt sintagmës, në të cilën kjo njësi është kokë e saj* (Michaelis 2006, 72-73).

Në këtë kontekst Zwicky (1995); Jackendoff (1997); Sag et al (2003) flasin për parimin e projektimit leksikor, sipas të cilit *fjalët krijojnë kufijtë e marrëdhënieve potenciale më të ngushta, duke specifikuar tipat e komplementeve, adjunkteve, determinantëve që ata ose kërkojnë ose mirëpresin*.

Me këtë po u referohemi punimeve tona⁴ si: Albana Deda & Daniela Hasa, “Issues of Gradability in Albanian Language Traditional Studies”, 2011, Albana Deda & Leonora Lumezi, The Traditional Conception of Diathesis (Voice) and a Modern View to It, 2015 .

Goldberg-u u referohet Fillmore-it dhe Kay-it (1993), Kay & O’Conor-it (1998), Lakoff-it (1987), Brugman-it (1988), Lambrecht-it (1994) etj., të cilët me punimet e tyre krijuan terrenin e zhvillimit të Gramatikës Kostruktive (Goldberg 1995, 6).

Dihet se në Gramatikën Gjenerative, leksikoni dhe niveli sintaksor janë parë si nivele të ndara. Në këtë kontekst, Chomsky (1989: 43) do të theksonte:

[A] language is not a system of rules, but a set of specifications for parameters in an invariant system of principles of [universal grammar], and traditional grammatical constructions are perhaps best regarded as taxonomic epiphenomena – collections of structures with properties resulting from the interaction of fixed principles with parameters set one way or another. ([A]gjuha nuk është një sistem rregullash, por një grup specifikimesh për parametrat në një sistem parimesh [gramatika universale], dhe konstruktet gramatikore tradicionale ndoshta konsiderohen si koleksione epifenomene taksonomike – koleksione strukturash me veti/pasuri, që vijnë si rrjedhim i ndërveprimit të parimeve fikse me parametra të vendosur në një mënyrë ose në një tjetër.).

⁴ Albana Deda, Diateza: kategori morfologjike apo valencë (monografi), 2017, Albana Deda, The necessity to study the semantic valence in the structure of albanian language, 2019 . Albana Deda & Idriz Metani, Means in the context of the compound predicate or complete verbs (data by Gege and Toske dialects), 2020 , Albana Deda& Monica Genesi& Monica Hasani, The Conceptual Metaphor and the Need to Identify It in the Albanian Literary Corpus, 2023 . Albana Deda &Monika Hasani, Word Formation Head and the Typology Analysis of the Word Formation Corpus in Albanian, 2023 .

Duke iu referuar këtij pohimi Michealis sqaron se: *Në këtë pikëpamje, modelet sintaksore të një gjuhe nuk janë të licencuara nga gramatika e asaj gjuhe. Ato janë thjesht artefakte të ndërveprimit ndërmjet kufizimeve universale dhe të veçanta gjuhësore. Gramatika Konstruktive (CxG) u krijua pjesërisht për t'ju kundërvënë pikëpamjeve reduksioniste të sintaksës dhe semantikës së përshkruar më sipër, por në të njëjtën kohë ajo përfaqëson një kthim në një “taksonomikë” tradicionale për nga mënyra e analizës gramatikore. Përkrahësit e CxG janë përpjekur të tregojnë se ka kufizime në formë dhe interpretim që nuk mund të shpjegohen veç si prodhime të ndërtimeve gramatikore, çiftime formëkuptim të shkallëve të ndryshme të produktivitetit dhe kompleksitetit të brendshëm (Michaelis 2006, 73).*

Teoricienët e CxG theksojnë se *fjalë me përmbajtje si emrat dhe foljet, pra e kanë fjalën për semantikën e tyre (A.D.) nuk veprojnë si numrat, sepse konteksti sintaksor përcakton çfarë lloj ngjarjeje, prone ose entiteti fjala tregon, pra se çfarë përfaqëson sjellja e kombinuar e asaj fjale* (Goldberg 1995; Michaelis dhe Ruppenhofer 2001; Goldberg dhe Jackendoff 2004).

Çfarë është gjuha sipas konstruktivistëve

“Cila është pasuria sekrete e gjuhës që na lejon të bëjmë gjithë këto gjëra (të pyesim, të përgjigjemi, të emocionojmë, të shajmë, të mallkojmë të bëjmë intriga etj.) pyet Thomas Hoffmann në manualin *Construction Grammar* (Hoffmann 2022, 1).

Përgjigjja e kësaj pyetjeje fundamentale që është zanafilla e shumë teorive gjuhësore për

Hoffmann-in qëndron në faktin se *të gjitha aspektet nga krijimi /shpikja e fjalëve të reja deri në thënien e fjalive të plota mbetet një proces konjitiv qendror: të menduarit simbolik* (Deacon, 1997)-*që do të thotë aftësia jonë që në mënyrë arbitrare të magazinojmë çifte/ çiftime të formës dhe kuptimit (pairings of form and meaning* (Hoffmann 2022, 1).

Adelë Goldberg-u e hap manualin e saj me të njëjtin pohim: *Një nga tezat qendrore të këtij punimi është që tipat e fjalive bazë të anglishtes janë shembuj të konstrakteve të korrespondencave formë -kuptim, që ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga foljet e veçanta* (Goldberg 1995, 2).

Nëse te Hoffmann-i fillimisht mund ta lidhësh pohimin me pohimet sosyriane (natyrisht pa parë mënyrën si e trajton më tej ai), te Goldbergu nuk ka dyshim që dikotomia nuk mund të merret gjerësisht si referencë, në korpusin që hulumton ajo gramatika tradicionale nuk ka një trajtim të tillë për përbërësen semantike:

Po sjellim në vëmendje konstruktet me të cilat merret ajo: “Në këtë punim unë zhvilloj idenë se konstruktet e strukturës argumentore janë një nënklasë speciale

e konstrakteve që përftojnë /krijojnë mënyrat bazë të shprehjese së fjalisë në një gjuhë” (Goldberg 1995, 3). Konstruktet me të cilat Goldberg merret në manualin e saj janë:

- | | |
|--------------------------------------|---|
| 1. Ditransitive | X shkakton që Y të marrë Z (S, V, Obj, Obj ₂)
<i>Pati i shkruajti Billit një letër.</i> |
| 2. Lëvizje/zhvendosja e shkak-tuar | X shkakton që Y me zhvendos/lëviz Z (S, V, Obj, Obl) <i>Pati fryu letrën nga tavolina.</i> |
| 3. Rezultative | X shkakton që Y të bëhet Z (S,V, OBJ, X _{compl})
<i>Ajo puthi atë, duke e lënë të çuditur.</i> |
| 4. Lëvizja /zhvendosja in-tranzitive | X lëviz/zhvendos Y (S, V, Obl)
<i>Flutura rrotullohej në dhomë.</i> |
| 5. Conative | X drejton veprimet drejt Y (S, V, Obl _{at})
<i>Sami kicked at bill/Sami gjuajti Billin.</i> (Hit , kick, cut, slash, Levin 1993, 41) |

Sipas Hoffmanit, në ***Gramatikën Konstruktive, gjuha është procesi mental që ka të bëjë me të folurën e një individi.***

Çfarë ka në aparatit tonë mental? Ka fjalë do thotë dikush. Po fjalët kanë formë dhe kuptim, kanë të shenjuar dhe shenjues (koncepti i shenjës gjuhësore, dikotomia arbitrarë e Sosyrit):

Formë (shenjuesi, tingulli, prerja fonetike)	/dārdh/
Kuptim (koncepti, i shenjuari)	Dardhë

Në CxG edhe fjalët (shenja gjuhësore) janë konstrakte. Në këtë mënyrë:

Konstrukt=formë & kuptim

Kështu matrica konstruktive në lidhje me njësinë dardhë do të ishte më e specifikuar:

{	{	}	}
	{	}	

Formë Fon. /dārdh/
Sint/Kat. Emër, gjini...

Kuptim ‘dardhë’

Pra forma ka attribute që janë tipare fonetike dhe sintaksore, të cilat nga ana e tyre kanë vlera, që u referohen shqiptimit specifik, kategorive sintasore (emër, gjini, numër, rasë) etj.

Po kështu, edhe kuptimi ka atributin e tij dhe specifikohet më tej në vlera veçanërisht për konstruktet komplekse, për të cilat do të flasim më poshtë.

Shtrohet pyetja: Gramatika konstruktive që **merret me të menduarit simbolik, pra me çiftimin e formës me kuptimin**, ka në fokus vetëm fjalët?

“Vajza ime po më tregonte se një shoku i saj nuk kishte marrë lekë të blinte diçka për të ngrënë dhe dikush i tha: *Lene se është pabuks.*”

Ky mbiemër nuk gjendet në fjalorin e gjuhës shqipe. Natyrisht që një përdorues i shqipes e di se njësia /pa/ ka kuptimin e [nuk ka] dhe se zakonisht shoqërohet me fjalë (mbiemra, ndër të tjera) për të dhënë të kundërtën e tyre: *i papjekur, i papërtuar, i paharruar.*

Konstruktivistët⁵ thonë se, duke u nisur nga kjo referencë semantike, përdoruesi dallon se kuptimi i saj ka lidhje *me dikë që nuk ka bukë* (dhe me metonimi *nuk ka para*, duke qenë në **slotin/elementin skematik**/vendin e një mbiemri shtohet edhe prapashtesa -s). Kjo do të thotë se njësia /pa-/ është e modifikuar me formë e kuptim përkatësisht në njërin nga modelet (se ka dhe të tjerë):

Formë [pa1/XMb2]Mb3

Kuptim ‘NUK KA1-XMb2’3


Në këtë model shenja komplekse konfigurohet në këtë mënyrë⁶:

[pa1/XMb2]Mb3 ‘NUK KA1-XMb2’3

Matrica: $\longleftrightarrow$ Formë

⁵ <https://www.youtube.com/watch?v=LDMsVKJBBYM&list=PLnWwkfEFUccgAbB169CgZNtN0ranrKQN5>.

⁶ Shigjeta është lidhja simbolike.



Fon. /pa₁X₂/

Sin/Kat. Mb., gjini..

Kuptim ‘Nuk ka X₂

Kjo do të thotë se edhe morfema duhet konsideruar si konstrukt, pasi ka çiftëzimin formë kuptim (pairing).

Kështu konstrukti konceptohet edhe në nivel morfeme.

Shohim një lloj tjetër konstrukti:

Sa herë të kam thënë mos me i zënë besë atij.

Nëse analizon këtë fjali tradicionale, natyrisht që është e dallueshme se kuptimi i saj nuk është “kompozicional” (Hoffmann 2022, 2), pra nuk është shuma e kuptimeve të fjalëve tradicionale. Të paktën grupi “me i zënë besë dikujt” vihet re se ekuivalentohet me kategorinë leksikore “besoj”. Vihet re se ky grup ka një formë fonologjike më të fiksuar, pra ka njësi që nuk ndryshojnë. Kemi të bëjmë me një idiomë tradicionale.

Elementet e idiomës, që nuk ndryshojnë quhen **elemente substantive** (Croft & Cruise 2004, 255). Në këtë rast elementi kryesor që nuk ndryshon është “besë”.

Po kështu kemi dy **elemente skematike/slots**⁷, që ndryshojnë në formë e në referencë: kryefjala tradicionale (unë, ti, njerëzit, mirazhet etj.), kundrina e zhdrejtë (atij i, njerëzve, inatit).

Veç këtyre, kemi edhe një njësi që është **gjysmë slot** dhe **gjysmë element substantiv**. Ky element është folja *zë/me zënë*, që këtu është në trajtën e infinitivit *me zënë*, po mund të marrë edhe forma të tjera të paradigmes. Paraqitja skematike e këtij konstrukti do të ishte:

Konstrukti: X_y zë besë Y.

Formë: [Sub1 Obj2zë besë3 Obj2]idiom4



Kuptimi: A₁ [nuk_{B2} zë besë]₃ B₂⁴

Natyrisht që kjo skemë nuk përfaqëson gjithë larmishmërinë e idiomave, të cilat mund të kenë më shumë elemente substantive (Fliste *si e ëma e Zeqos në majë të thanës*). Idiomat gjithashtu shihen si konstrukte.

⁷ Slots- elemente skematike që ndryshojnë në idiomë ose konstrukt.

Konstrukte konceptohen edhe **struktura të caktuara argumentore**. Po marrim një nga konstruktet e diskutuara nga Goldberg-u për anglishten, që e gjejmë edhe në shqipe:

Konstruktet Ditransitive⁸: X shkakton që Y të marrë Z (S, V, Obj₁, Obj₂): *Bora i shkroi Drinës një letër*⁹.

Kështu konstruktet ditransitive mund të shihen si rast polisemie konstruktive. E njejta formë është e shoqëruar me kuptime të ndryshme, por të lidhura.

Bora i dha Drinës një makinë.

Bora i transferoi Drinës para në llogari.

Siç mund të shihet, ajo që i bashkon këto tri fjali është korniza konceptuale (frame), e cila ka të bëjë me transfertën e vullnetshme të diçkaje drejt dikujt.

Goldberg-u shprehet se *Strukturat e fjalisë së thjeshtë janë të lidhura direkt me strukturat semantike, që reflektojnë skena bazë të përvojës njerëzore. Në veçanti, strukturat që përfshijnë strukturën argumentore bazë shihen të lidhura me skenat dinamike: skena të bazuara në përvojë si p.sh. dikush që në mënyrë të vullnetshme i transferon diçka një tjetri (rasti më lart ditransitiv), dikush që shkakton që diçka të lëvizë a të ndryshojë gjendje, dikush që eksperimenton diçka, dikush që lëviz etj* (Goldberg 1995, 5).

Për të tri fjalitë më lart do të kishim këtë prezantim në nivel forme dhe kuptimi:

Forma: [Subj₁ Obj₃ F₂ Obj₃ Obj₄] Konstrukt ditransitiv₅



Kuptimi : [A₁ i shkakton B₃ me pasë B₄]/

A₁ do të përbënte vepruesin/agjentin, B₃ do të ishte marrësi/recipienti, kurse B₄ do të ishte objekti/tema e përvojës në raste të caktuara.

Siç mund të shihet, përveç kornizës kryesore konceptuale, që gjithsesi ndërthur përbërësen semantike mentale në proces, qenia njerëzore përcepton edhe rolet specifike semantike që përfaqësojnë në gramatikën gjenerative rolet argumentore.

Kështu, sipas Hoffmann-it (2021), CxG përfshin **të folurit simbolik** që merret me çiftimin /korrespondimin e **formës me kuptimin** dhe përdoret për të shpjeguar se si punojnë **fjalët, morfemat, konstruktet argumentore, shprehje dhe fjali**

⁸ Më poshtë jepen raste foljesh të ndryshme ditransitive, të cilat veç kuptimeve bazë të përcaktuara në strukturën argumentore, mund të interpretohen edhe në mënyra të tjera në lidhje me efektet etj.

Obligation verbs (promise, guarantee, owe) jo domosdoshmërisht implikojnë transfertë: Billi i premtoi të birit një makinë.

Foljet që implikojnë të ardhmen (bequeath, leave, refer, forward etj.) për transfertën.

Foljet e lejimit (lejoj) që tregon se agjenti bën të mundur tranfertën, po jo se e parashikon atë.

Foljet e refuzimit (refuzoj/ refuse, deny) shprehin mohimin, negacionin e transfertës.

⁹ Vetëm ky shembull është i Goldberg-ut. Të tjerët i kemi marrë nga shqipja, megjithëse emrat e përveçëm janë në anglisht.

dhe çdo gjë që leksikoni dhe struktura sintaksore duhet të përftojë. Po kështu CxG duhet të përcaktojë mirë se çfarë të dhënash (data) duhen përcaktuar si struktura dhe se çfarë mund të thotë CxG për language acquisition (nxënien e gjuhës te fëmijët).

Duke qenë se parimi bazë në CxG është se konstrukti përfaqëson çiftimin e formës me kuptimin, gramaticienët kanë propozuar që leksikonin ta zëvendësojnë me termin konstruktikon:

lexicon $\longleftrightarrow$ construct-i-con

Në vijim Hoffmann-i (2021) rendit elementet që bëjnë pjesë në kontinuumin leksikon-sintaksë:

K. atomike	Substantiv	Leksikoni i fjalëve (word -lexicon),	/dārdh/ $\longleftrightarrow$ ‘dardhë’
K. atomike	Skematik	kat. sintaks.	[Emër] $\longleftrightarrow$ ‘objekt, gjë’ [Folje] $\longleftrightarrow$ ‘ngjarje’

Kuptimi qendror i konstrukteve ditranzitive mund të thuhet se përfshin një tranfertë të suksesshme të një objekti te një marrës, me referentin e subjektit, që në mënyrë të qëllimshme e shkakton këtë tranfertë (Goldberg, 1995: 32-33).

K. Komplekse	Lidhja skematike	morfologji	/Emër ₁ -Shumës/ $\longleftrightarrow$ ‘Shumës, E ₁ ’ /pa ₁ -Mb/ $\longleftrightarrow$ ‘Nuk ka-Mb’
K. Komplekse	Më së shumti substantive ⁹	idiomat	[A ₁ B ₂ zë besë ₃ B ₂]idiom ₄ $\longleftrightarrow$ ‘A ₁ [B ₂ zë besë] ₃ B ₂ ’ ₄
K. Komplekse	Skematike	K. sintaksore	[X ₁ Y ₃ F ₂ Y ₃ Z ₄] Konstrukt ditranzitiv ₅ $\longleftrightarrow$ [X shkakton Y me pasë Z]

Nëse marrim foljen *largoj* dhe emrin *largim*, në pamje të parë të shkëputur nga kontekstet ato pothuajse tregojnë të njejtën gjë: *dikush lagohet për diku*¹⁰ (*largoj* -dikush duhet, mund, do të, është larguar për diku/ largimi-presupozon se dikush është, ka qenë larguar për diku). Po kur themi:-

Ajo u largua për në shkollë.

Largimi i saj nga puna na bëri përshtypje.

Në aparatit tonë mental në këtë rast integrohen edhe elemente të tjera të situatës: ajo dhe statusi i saj, dëshira për të shkuar ose jo, koha dhe aspekti i veprimit të saj.

Shpejtësia/ngadalësia e largimit, diçka e pazakontë në krahasim me diçka të

¹⁰ Në kuptimin që kanë elemente që nuk ndryshojnë.

¹¹ Në një skenë/frame, se ka disa të tilla.

zakontë etj. (Hoffmann, 2021¹²).

Pra, kur e kemi në fjali në një skenë, në një ngjarje ne e konceptualizojmë rastin e parë ndryshe nga i dyti.

Në lidhje me konstruktin kompleks ditranzitiv kuptimi mund të specifikohet më tej me role semantike. Pëkatësisht X është agjenti, Y është recipienti/marrësi dhe Z është tema.

Dallimi mes CxG dhe gramatikave që bazohen në rregulla (Rule-based Grammars)

Edhe për aq sa u tha deri më tani mund të shihet dallimi me CxG dhe gramatikave të tjera. Duke iu referuar analizave strukturaliste, përkatësisht Quirk & al (1985), Hoffmann-i (2021) përcakton se në këto gramatika gjuha = fjalët (e kuptimshme)+ rregullat sintaksore (pa kuptim).

Në këtë mënyrë sintaksa nuk mund të ndryshojë kuptimin. Kështu, ato nuk analizojnë strukturën e idiomave dot, po e marrin si të tërë bllok (krahasoni: *ai preu dorën /ai i preu fjalën*). Në përgjithësi, këto analiza merren më së shumti me-:

- Strukturën sipërfaqësore (*Të vizitosh kushërinjtë mund të jetë e mërzitshme. [ti/ata]*);
- Kuptimi në to nuk merret parasysh, ose është mjaft periferik në studimet sintaksore;
- Ka fenomene të caktuara që nuk mund t'i shpjegojë (ambiguitetin, kalimet aktiv/pasiv dhe anasjelltas, si dhe foljet e çrregullta, të cilat vetëm emërtohen si të tilla). Po sipas Hoffmann-it (2021), CxG ndryshon thelbësisht nga këto parime, pasi:

Përgjithësimi i saj drejton/çon në **konstrukte skematike** të çiftimit fomë-kuptim (siç pamë më sipër tri fjalitë/tri strukturat argumentore (*Drina i shkroi Borës një letër./Drina i dha Borës një makinë./Drina i transferoi Borës para në llogari.*) kishin të njëjtën **skemë konstrukt** që integronte edhe formën edhe kuptimin:

Forma: [Subj₁ Obj₃ F₂ Obj₃ Obj₄] Konstrukt ditranzitiv₅



Kuptimi : [A₁ i shkakton B₃ me pasë B₄]/

Po kështu CxG ndryshon edhe nga gramatika gjenerative.

Gramatika gjenerative është një gramatikë mentale që prodhon (gjeneron) fjali të pafundme nëpërmjet një numri të kufizuar fjalësh/njësish (items) të lindura të kuptimshme, të cilat kombinohen me rregulla sintaksore që nuk kanë kuptim (Hoffmann 2021).

Në gramatikën gjenerative, leksikoni ushqen /furnizon strukturën e thellë e kjo nëpërmjet Movement/Lëvizjes projekton strukturën sipërfaqësore. Struktura sipërfaqësore përsëri përmes lëvizjes/Movement ushqen formën fonetike dhe formën logjike, të cilat konceptohen të ndara njëra nga tjetra. Gramatika gjenerative i konsideron këto nivele si të ndara (modulare, Hoffmann, 2021).

¹² Ibid., 2021

Gjithshtu, gramatika gjenerative koncepton se performanca shumë pak ndikon te kompetenca, pasi ajo, performanca, shihet si e mbushur me gabime, duke i dhënë rëndësi të veçantë kështu kompetencës (gramatikës gjenerative mentale).

Në CxG inputi (performanca) është shumë i rëndësishëm dhe çon në përgjithësime skematike. Kjo gramatikë nuk është aspak modulare, pasi niveli formal dhe ai semantik shihen si të ndërthurura njëra me tjetrën (shigjeta sibolike me vektorë të dyanshëm).


Kështu, në fjalitë:

Stafi e zgjodhi atë Dekan.

Ata e bënë balerin.

Ata e përgatitën djalin si specialist.

Matrica konstruktive për të tria do të ishte:



Pra, CxG nuk është modulare dhe nuk i ndan nivelet e përgjithësimi. Gjithashtu, ajo nuk është derivacionale, pra nuk shihen në të operacione Lëvizjeje/Movement siç përshkruhen në Gramatikën Gjenerative (Tarzan kissed Jane/Jane was kissed by Tarzan.). Në **CxG përgjithësimet çojnë në konstrukte skematike**.

Le ta përmbledhim analizën më lart. Gramatika strukturaliste dhe ajo gjenerative e konceptojnë gjuhën si: gjuha = fjalë (të kuptimshme) + rregulla të pakuptimshme.

Nga ndryshojnë rregullat nga skemat konstruktiviste?

Natyrisht që ka raste kur rregullat dhe skemat konstruktive kanë të njëjtat rezultate, po ka, gjithashtu, raste që këto ndryshojnë dhe qasja konstruktive shfaqet më e favorshme.

Le të kujtojmë mbiemrat: i parregullt, i paharruar, i padëgjuar.


Teoritë që mbështeten në rregulla do të bënin këto përcaktime për to:

I harruar/i paharruar

Input $\longleftrightarrow$ output

[pa +Mb.] $\longleftrightarrow$ [pa-Mb.]

Nga qasja konstruktive matrica skematike ndryshon:



Në konstruktikon, pra në rrjetin mental të konstrukteve, këto dy skema janë të lidhura në mënyrë të ndërsjelltë, jo si në gramatikat e bazuara në rregulla, ku njëra ishte input-i dhe tjetra output-i. Hofmani (2021¹³) vëren se vërtet fëmija do ta mësojë njërën të parën, po në momentin që ajo është në kokë aktivizohen të dyja matricat njëherësh.

Ka raste që në konstruktikonin tonë të kemi vetëm njërën anë (outputin, pabuks). Për këto raste, gramatikat që mbështeten në rregulla nuk kanë përgjigje (Hoffmann, 2021).

Përfundime

Nga parashtrimi i mësipërm mund të dallohen përparësitë që teoria konstruktiviste CxG paraqet në lidhje me trajtimin strukturalist e atë gjenerativist, tashmë tradicionale. Ajo shpjegon në mënyrë më bindëse procesin e përthithjes së gjuhës amtare dhe asaj të huaj.

Gjithashtu, nëpërmjet saj këto procese shfaqen në tërësinë dhe natyrshmërinë e realizmit të tyre, pasi kjo teori i shpjegon, duke u referuar të dhënave të disa niveleve që realisht bashkëveprojnë në këto procese. Në këtë mënyrë shmangen shpjegimet e pjesshme modulare tradicionale strukturaliste, po qoftë edhe deri diku më të integruara gjenerative.

Në këtë kontekst, veçanërisht përbërësja semantike -konceptuale zë vendin adekuat që realisht i takon në këtë proces përkrah niveleve të tjera që tradicionalisht janë marrë parasysh më së shumti (niveli gramatikor e deri diku fonetik).

Nga ana tjetër, vetë kjo teori parashikon një tërësi dhe larmshmëri korpusi që nuk haset në dy drejtimet e tjera. Korpuset ligjërimore, si pasuria më e madhe komunikative njerëzore zenë një vend të rëndësishëm në këto diskutime.

Për arsyet më lart, po edhe të tjera, gjykojmë se korpusi i shqipes ka nevoja të domosdoshme për t'u parë dhe në dritën e kësaj teorie.

Bibliografi

Aart, B., Oxford Modern English Grammar, Oxford University Press, 2011. f.1.2.
Brugman, C., The Story of over: Polysemy, Semantics, and the Structure of the Lexicon. New York: Garland, 1998.

Croft, W., & Cruse, D. A., Cognitive Linguistics, Cambridge: Cambridge University Press, 2004 <http://dx.doi.org/10.1017/CBO9780511803864>

Deda, A. & Hasa, D., Issues of Gradability in Albanian Language Traditional Studies. Journal of Education and Social Research, Vol.4 Nr.2. , 2011. <https://www.youtube.com/watch?v=-mQsvNkAhp4&list=PLnWwkfEFUccgAbB169CgZNtN0ranrKQN5&index=6>

¹³ <https://www.youtube.com/watch?v=-mQsvNkAhp4&list=PLnWwkfEFUccgAbB169CgZNtN0ranrKQN5&index=6>

www.richtmann.org/journal/index.php/jesr/article/view/2790

Deda, A. & Lumezi, E., The Traditional Conception of Diathesis (Voice) and a Modern View to It, *European Journal of Language and Literature Studies*, Vo.1 Nr.1., 2015. chromeextension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://revistia.org/files/articles/ejls_v1_i1_15/Albana_Deda.pdf

Deda, A., Diateza: kategori morfologjike apo valencë (monografi), Mirgerald, 2017.

Deda, A., The necessity to study the semantic valence in the structure of Albanian language, *International Journal of Afro-Eurasian Studies*, 2019. <https://dergipark.org.tr/en/pub/ijar/issue/47918/607164>

Deda, A. & Metani, I., Means in the context of the compound predicate or complete verbs (data by Gege and Toske dialects), TENTH INTERNATIONAL CONFERENCE ON: “SOCIAL AND NATURAL SCIENCES – GLOBAL CHALLENGE 2020” (ICSNS X-2020), 2020. chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/https://iipcccl.org/wpcontent/uploads/2020/11/Lisboa-ICSNS-X-1.pdf

Deda, A & Genesin, M. & Hasani, M., The Conceptual Metaphor and the Need to Identify It in the Albanian Literary Corpus, *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 2023 <https://www.richtmann.org/journal/index.php/ajis/article/view/13552>

Deda, A. & Hasani, M., Word Formation Head and the Typology Analysis of the Word Formation Corpus in Albanian, *Journal of Educational and Social Research*, 2023. <https://www.richtmann.org/journal/index.php/jesr/article/view/13598>

Fillmore C J, Kay P & O'Connor M C., ‘Regularity and idiomaticity in grammatical constructions: the case of let alone.’ *Language* 64, 1988, f. 501–538.

Goldberg, A., *Constructions: a construction grammar approach to argument structure*, Chicago: University of Chicago Press, 1995.

Goldberg, A., ‘Surface generalizations: an alternative to alternations,’ *Cognitive Linguistics* 13, 2002, 327–356.

Goldberg, A. & Jackendoff, R., The English resultative as a family of constructions, *Language* 80, 2004, f. 532–568.

Harris, R. & Taylor, T., *Landmarks in Linguistic Thought 1: The Western Tradition from Socrates to Saussure*, Psychology Press. Routledge, 1997.

Hoffmann, Th., *Construction Grammar, The structure of English*, Cambridge University Press, New York, 2022.

Kallulli, D., A unified analysis of passives and anticausatives, *Empirical Issues in Syntax and Semantics* 6 O, Bonami & P. Cabredo Hofherr (eds.), 2006. [chrome-

xtension://efaidnbmnribpcajpcglclefindmkaj/http://www.cssp.cnrs.fr/eiss6/kallullieiss6.pdf]

Kananaj, A., Teoria e roleve tematike dhe probleme që lidhen me të në gjuhën shqipe, Studime filologjike nr. 3-4, 2009.

Koleci, F. & Turano, G. Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes, SHBLU, 2011.

Kay P & Fillmore C., 'Grammatical constructions and linguistic generalizations: the "what's X doing Y" construction.' *Language* 75, 1999, f. 1–33.

Kay, P., English subjectless tagged sentences, *Language* 78, 2002, f. 453–481.

Lakoff, G., *Women, fire and dangerous things: what categories reveal about the mind*, Chicago: University of Chicago Press, 1987.

Lambrecht, K., *Information structure and sentence form: Topic, focus, and the mental representation of discourse referents*, Cambridge: Cambridge University Press, 1994. doi:10.1017/CBO9780511620607

Memushaj, R., *Gjuhësia gjenerative*, Tiranë, ShBLU, 2003/2008.

Michaelis, L. A. & Lambrecht, K., Toward a construction-based theory of language function: the case of nominal extraposition, *Language* 72, 1996, f. 215–247.

Michaelis, L. A. & Ruppenhofer, J., *Beyond alternations: a constructional model of the German applicative pattern*, Stanford: CSLI Publications, 2001.

Michealis, L., *Construction Grammar*. University of Colorado at Boulder, Boulder, CO, USA_ Elsevier Ltd, 2006.

Plag, I., *Word formation*, Cambridge University Press, 2002. f 4-9.

Pullum, G. & Zwicky, A., Condition duplication, paradigm homonymy and transconstructional Constraints,' In Sutton L, Johnson C & Shields R (eds.) *Proceedings of the Seventeenth Annual Meeting of the Berkeley Linguistics Society*, Berkeley: Berkeley Linguistics Society, Inc., 1991, f. 252–266.

Zwicky, A., Dealing out meaning: fundamentals of grammatical constructions.' In Gahl S, Dolbey, A. & Johnson, C. (eds.), *Proceedings of the Twentieth Annual Meeting of the Berkeley Linguistics Society*. Berkeley: Berkeley Linguistics Society, Inc., 1994, f. 611–625. Zwicky, A., 'Exceptional degree markers: a puzzle in internal and external syntax.' *Ohio Working Papers in Linguistics* 47, 1995, f. 111–123.

Thomai, J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, SHBLU. 2006.